

Pershendetje kolege dhe miq!

Fillimisht desha te falenderoj ekspertet Italiane te ndermjetesimit dhe arbitrazhit qe jane sot present mes nesh, organizatoret - Dhomen e Tregtise Durrës dhe Universitetin Jopublik "Marin Barleti" si dhe pjesmarresit ne kete seminar.

Une do te deshiroja dhe e mendoj te vlefshme qe fillimisht, ne hyrje te prezantimit, te bej nje pasqyre te tradites dhe situates aktuale te Ndermjetesimit ne vendin tone.

Pajtimi dhe ndermejtësimi si modele konsensuale te zgjidhjes se konflikteve, ndonese nuk kane patur nje nivel te larte institucionalizimi ne te shkuaren, nuk mund te konsiderohen si modele krejt te reja.

Ne te drejten zakonore te vendit tone gjejme te sanksionuar ndermejtësimin si alternative te zgjidhjes se konflikteve, mjafton te kujtojme Kanunin e Leke Dukagjinit "paragrafi 668 dhe paragrafi 682"

Gjithashtu, rolin ndermjetesues e ka huazuar edhe e drejta shteterore ne periudhat e viteve pas Luftes se Dyte Boterore, ku gjykatat e Fshatit dhe te Lagjes te njohura si *Gjykata Shoqerore*, te krijuara qysh ne vitin 1968 dhe te njohura si hallka perberese te sistemit gjyqesor, **gjate gjykimit duhet te benin te gjitha perpjekjet per pajtimin te paleve ne konflikt.**

Ne vitin 1994 eshte ngritur dhe institucionalizuar Fondacioni i Pajtimin te Mosmarreveshjeve me iniciativen e vyer te Z. Rasim Gjoka. Perpjekjet e ketij fondacioni si edhe klima e re legjislative e pas viteve 1990 ne shqiperi, kane bere qe, ndermejtësimi si alternative e zgjidhjes se konflikteve te jete i perfshire ne shume kode e akte ligjore.

Eksperienca jone e pare me nje ligj **te posacem** te ndermjetesimit perkon me Ligjin nr. 8465, date 11.03.1999 “Per ndermjetesimin per zgjidhjen me pajtim te mosmarreveshjeve” i cili ne fakt, nuk parashikonte ndermjetesimin si alternative te zgjidhjes se mosmarreveshjeve tregtare. Ky ligj eshte shfuqizuar nga Ligji nr. 9090, date 26.06.2003, “Per ndermjetesimin ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve” me te cilin **eshte perfshire ndermjetesimi** si alternative e zgjidhjes se mosmarreveshjeve tregtare.

Aktualisht ne Durres, ne bashkepunim me Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Durres dhe Fondacionit per Zgjidhjen e Konflikteve, ne Mars te vitit 2009, prane kesaj Gjykate eshte ngritur dhe funksionon Zyra per zgjidhjen e konflikteve tregtare me ndermjetesim.

Nga aktiviteti i zyres se ndermjetesimit, deri ne fillim te ketij muaji, jane arritur keto tregues; Jane paraqitur ne Zyre 48 ceshtje per tu zgjidhur me ndermjetesim, nga te cilat, 27 raste jane zgjidhur me pajtim, 15 raste nuk jane zgjidhur, ndersa 6 raste jane ne proces. E shprehur ne perqindje, 56% e rasteve jane zgjidhur me pajtim, ndersa 31% e tyre nuk jane zgjidhur me pajtim.

Pozitiv eshte fakti se, pjesa me e madhe e mosmarreveshjeve te ndermjetesuara dhe te zgjidhura me pajtim jane ekzekutuar nga palet, ndersa rastet e tjera jane ne ekzekutim e siper dhe ne nuk kemi asnje reklamim nga palet.

E shprehur ne vlere monetare, nga aktiviteti ndermjetesues i zyres jane cliruar rreth 2.5 milion euro.

Natyra mosmarreveshjeve tregtare qe kemi ndermjetesuar dhe qe zyra ka krijuar tashme eksperiencen e saj, lidhet me mosmarreveshje nga konfliktet e pronesise ne biznes, kontratat e shitjes, sipermarrjes, transportit, qira financiare, konflikte te lidhura me funksionimin, organizmin e brendshem dhe vendimmarrjen e shoqerive tregtare,

operacione te ndarjes se shoqerive, likujdimin, veprimet e administrimit, transferim aksionesh, etj.

Gjithashtu, me ndermjetesim kemi zgjidhur konflikte te natyres civile, por me nje impakt tregtar si, demshperblim pasuror dhe jopasuror, si edhe konflikte per ceshtje familjare qe lidhen qe kane pasoja ne biznes si p.sh pjestim i pasurise bashkeshortore pas zgjidhjes se marteses, etj.

Tashme per **Ne** eshte e qarte se ndermjetesimi paraqet disa avantazhe ne raport me procedurat e tjera, si;

- proces i shpejte
- konfidencial
- avantazh per te mbajtur nen kontroll kostot dhe leshimet reciproke
- premisa qe palet te vazhdojne marredheniet ne te ardhmen
- karakteri i detyrueshem i akt-marreveshjes
- ne ndermjetesim palet konsiderohen dhe emertohen “pale ne proces” dhe jo me termat padites-i paditur-keqberes-demtues-i pandehur, te cilat krijojne nje gjendje te rende psikologjike per palet dhe perkatesi te fajit edhe pa ekzistuar ai

pra avantazhe keto qe sigurojne lehtesi dhe **interes per komunitetin e biznesit.**

Te gjitha e dime se, e vecanta ne ndermjetesim tregtar qendron tek **faktori interes**, i cili eshte i mbi cmuar ne raport me faktoret e tjere. Ne ndermjetesimin tregtar nuk ndermjetesohen vetem palet, por ndermjetesohen konfliktet e brendshme **dhe vecanerisht interesat e brendshme te paleve.**

Eshte **interesi**, faktor dominues ne nje mosmarreveshje tregtare qe i percakton tregtarit nese do te ndjete proceduren gjyqesore apo te ndermjetesimit ne zgjidhjen e

konfliktit, nese do te lidhe marreveshje pajtimi apo jo me palen tjeter, kushtet e marreveshjes, etj.

Duhet te ve ne dukje se, ndermjetesimi si alternative jashtegjyqesore e zgjidhjes se mosmarreveshjeve tregtare, ka hasur ne problematika te ndryshme, per shkak te prezences se vone te bazes ligjore per kete qellim **e si rrjedhoje** mungeses se kultures juridike te biznesit per alternativat jashtegjyqesore te zgjidhjes se konflikteve, krijimit dhe zhvillimit te vone (pas viteve 1991) te biznesit privat ne shqiperi, por nga ana tjeter ritmet me te cilat ai po zhvillohet dhe permiresimet e reja ligjore qe po behen ne kete drejtim, jane treguesi me i mire se jemi ne rruge te mbare.

Sfida jone e radhes eshte te ndergjegjesojme dhe sensibilizojme komunitetin e biznesit per avantazhet qe ka alternativa jashtegjyqesore e ndermjetesimit ne zgjidhjen e konflikteve tregtare.

Per kete qellim po bashkepunojme me Dhomat e Avokatise, Dhomat e Tregtise si forume qe perfaqesojne interesat e biznesit si dhe me vete komunitetin e biznesit dhe po ashtu jemi te kenaqur qe bashkepunojme dhe ndajme eksperiencat tona me Ju sot, per menyrat sesi ta **ndihmojme dhe mbeshtesim biznesin me nje sherbim ligjor te vecante sic eshte ndermjetesimi.**

Ne perfundim, deshiroj t'a mbyll prezantimin ashtu sic e fillova, duke ju falenderuar te gjithëve.